REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 236/22
Datë/Datum. 19.08.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

PSH.nr 236/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej z. Agon Ramadani - Kryetar, znj. Kimete Gashi- Referuese dhe znj. Nita Bejta– Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "International Security Association "shpk - Prishtinë, pjesëmarrës në ftesën për ofertë lidhur me tenderin: "Sigurimi fizik i objekteve te Sistemit Prokurorial te Kosoves" me nr. prokurimi: 250-22-2969-2-1-1, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Këshilli Prokurorial i Kosovës , më datën: 18. 08. 2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET pajtimi i palëve për ankesën 236/22, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi fizik i objekteve te Sistemit Prokurorial te Kosoves" me nr. prokurimi: 250-22-2969-2-1-1, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Këshilli Prokurorial i Kosovës.

II. OBLIGOHET, AK- Këshilli Prokurorial i Kosovës për aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve te Sistemit Prokurorial te Kosoves" me nr. prokurimi: : 250-22-2969-2-1-1, konform raportit te ekspertit shqyrtues me te cilin AK është pajtuar, lënda të kthehet ne **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se është aprovuar pajtimi i paleve, OE ankues i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Me datën: 26.06.2022, "International Security Association "shpk - Prishtinë ka parashtruar ankesë me nr: 236/22, kundër vendimit për anulim të tenderit, i AK- Këshilli Prokurorial i Kosovës për aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve te Sistemit Prokurorial te Kosoves" me nr. prokurimi: : 250-22-2969-2-1-1

OE ankues në ankesë pretendon se AK, ka eliminuar OE ankues padrejtësisht lidhur me dy pika pretenduese.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 28.06.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 06. 07. 2022, në raportin e ekspertizës ka deklaruar:

Sqarimi i lëndës nga eksperti shqyrtues

- Pergjigjeje e pretendtimet ankimore nr.1 per validitettin e sigurimit te tenderit.

Ky pretendim ankimor i OE-se ankuese eshte i bazuar sepse nga shkresat e lendes shihet sigurimi i tenderit ka validitet bile me shume se sa eshte kerkur. Sigurimi i tenderit eshte nxierr me dt.18.05.2022 dhe ka validitet deri me 16.09.2022,
Nje llogaritje e thjesht po te behet del ky rezultat.Sigurimi i tenderit i ka mbuluar keto dite sipas mujave kur eshte nxierr:
Maj 14 dite
Qershor 30 dite
Korrik 31 dite
Gusht 31 dite dhe
Shtator 16 dite, pra 14+30+31+31+16= 122 dite,ketij sigurimi edhe po te mos i llogariten edhe dita kur eshte nxierr pra 18 Maj 2022 po ashtu edhe dita kur ka perfunduar,dt.16 Shtator 2022, ky sigurim prap mbetet me validitet sipas kushteve te NJK-se dhe Dosjes se tenderit, per gjdo rast po ua bashkangjesim edhe sigurimit e tenderit ne fjalë:
Deshmi Sigurimi I tenderit…

PRISIG

DEKLARATA E GARANTUESIT
Sigurim Tenderi

Serial\ 0600101820193

Për Keshilli Prokurorial i Kosovës
(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PATUR PARASYSH SE International Security Association SH.P.K.
(emri i operatorit ekonomik, më tej "Tenderuesi")

Ka marrë përsipër të depozitojë sigurinë e tenderit që i referohet Dosjes së Tenderit, me Titull
Sigurimi fizik i objekteve te Sistemit Prokurorial te Kosovës, Nr. i Prokurimit:
250-22-2969-2-1-1 e dërguar nga Autoriteti Kontraktues:
(Nr.i referencës së Prokurimit)

DUKE PATUR PARASYSH SE Tenderuesi dëshiron të depozitojë një garanci për shumën e specifikuar në Dosjen e Tenderit:

DUKE PATUR PARASYSH SE jemi pajtuar që Tenderuesit j'i japim një garanci të tillë:
PRANDAJ NE nëpërmjet kësaj konfirmojmë se ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juaj në emër të Tenderuesit, deri në totalin prej: € 6,000.00
Gjasht mije €
(Shuma e garancës me shifra dhe me fjalë)

dhe ne marrim përsipër f'ju paguajmë, pas kërkesës së juaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet se tenderuesi është në mungesë për shkak se:

- Autoriteti Kontraktues ka vendosur, duke u bazuar në fakte objektivisht të verifikuara se Tenderuesi ka dhënë Autoritetit Kontraktues informacione përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese; ose
- Tenderuesi ka tërhequr tenderin pas skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve por para skadimit të përfundhës së vlefshmërisë së tenderit të specifikuar në Dosjen e Tenderit; ose
- Tenderuesit i është dhënë kontrata përkatëse, në bazë të tenderit të tij dhe Tenderuesi pastaj refuzon ose dështon:

1. që të depozitojë çfarëdo sigurie të kërkuar të ekzekutimit që është specifikuar në Dosjen e
2. që të përmbush çfarëdo kushti tjetër që është specifikuar në Dosjen e Tenderit, para nënshkrimit të kontratës përkatëse, ose
3. të nënshkruajë një kontratë që përputhet me kushtet e specifikuara në Dosjen e Tenderit;

dhe pa ankim ose pa argument, çdo shumë ose shumat brenda limitive € 6,000.00
për të cilat u fol, pa pasur nevojë që ju të dëshmoni ose të demonstroni bazën ose arsyet e kërkesës së juaj ose ndaj shumës së specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës 18.05.2022 deri më 16.09.2022

Lëshuar në PRISHTINE datë 18.05.2022

Nënshkrimi dhe Vula e Garantuesve

PRISHTINE

0016411

Prandaj siq shihet edhe ne kete sigurim te tenderit qe e keni te bashkangjitur ,pretendimi ankimor i OE-se eshte i bazuar.

<u>- Pergjigjeje ne pretendimin e dyte lidhur me deklaraten per paisjet per sigurim dhe licencen nga MPB.</u>

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor per at se OE-se ankuese i mungojn te bashkngjitura nje deklarat per paisje te deshmuar me foto ,me raport por edhe licencen per Sherbimet Themelore te Sigurimit,duhet theksuar se ky pretendim eshte pjesserisht i bazuar sepse nga shkresat e lendes,qe OE- ankuese ka ngarkuar ne sittem te prokurimit elektronik, shihet se Ky OE-e ka te bashkangjitur Raportin per paisjet me pershkrim detal te deshmura edhe me foto te piasjeve,po ashtu edhe Licencen per Sherbime Themelore te Sigurimit e Leshura nga Ministria e Punve te Brendshme me validitet deri me 25.03.2023. edhe per kete po u bashkangjesim deshmit qe kane qene te ngarkuar ne oferte te OE-se ankuese.

Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Ministria e Punëve të Brendshme/Ministarstvo unutrašnjih poslova/ Ministry of Internal Affairs

LICENCE /LICENCU /LICENSE

PËR SHËRBIMET THEMELORE TË SIGURIMIT
ZA OSNOVNIH USLUGA OBEZBEĐENJA
FOR BASIC SECURITY SERVICES

I lëshohet / Izdaje se za / Is issued for

International Security Association sh.p.k

Data e skadimit/ Datum isteka/ Expiry date: 25/03/2023

Numri i licencës/Br. Licence/No. of License
2020/0009

Shërbimet Private të Sigurisë/ Usluge Privatne Bezbednosti/ Private Security Services

Prandaj mendoj se edhe pretendimi i dytë ankimor i OE-se eshte i bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues te OSHP-së qe ankesa te pranohet si e bazuar,AK të anulon Vendimin per Anulim te tenderit dhe lenda te kthehet ne Rivleresim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 07 Korrik 2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues Këshilli Prokurorial i Kosovës me datën 07 korrik 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së.

Operatori ekonomik ankues "International Security Association "- Prishtine me datën 07 korrik 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklarimeve të palëve se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues për anulimin e aktivitetit të prokurimit deklaron se procedura e shqyrtimit të ankesës përfundon në këtë fazë, ndërkaq obligohet Këshilli Prokurorial i Kosovës që njoftimin për anulim ta anuloj dhe lënda te kthehet ne Ri-vlerësim sipas mendimit të ekspertit shqyrtues dhe brenda afatit 10 ditor konform LPP-së ta njoftoj panelin shqyrtues me veprimet e ndërmarra.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetar i PSH-së
Z. Agon Ramadani

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK- Këshilli Prokurorial i Kosovës
1x1 International Security Association shpk - Prishtinë
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.